



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:

**NDERTIM ZYRE INFORMACIONI - INFOPOINT 26m²
PER TURISTET NE SEZONIN E VERES
NE SHENGJIN, LEZHE**

Faza Projekt - Zbatimi

LEZHE 2023

A handwritten signature in blue ink, located in the bottom right corner of the page.

PERMBAJTJA

1. Hyrje
2. Pozicioni i objektit.
3. Gjendja ekzistuese
4. Objektivat
5. Kushtet klimatike
6. Menyra e realizimit te projektit.
7. Hartimi I projektit.
8. Zgjidhja e projektit.
9. Grafiku I punimeve
10. Punimet dheu.
11. Zbatimi

1. Hyrje

Lezha është një qytet bregdetar veri-perëndimor i Shqipërisë. Ndër vite është shquajtur për pozicionin gjeografikë që ka, duke qënë se një qytet i vogël si Lezha ka asete si historike dhe topografike të përshtatshme për të zhvilluar turizmin bregdetar dhe malor. Zona e Shengjinit gjatë sezonit veror që zgjat 6 muaj mbipopullohet nga turista të shumtë.

Sipas statistikave të Instatit (Figura 1) kulmin e turistëve në Shqipëri është arritur në vitin 2019. Meqënëse dita ditës bota po digjitalizohet dhe drejtohet nga teknologjia, zyrat e informacionit krijojnë një aksesibilitet në qasjen e këtij informacioni për turistat.

Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajoneve, 2014-2021								
Arrivals of foreign citizens according to regions, 2014-2021								
Númer								Number
Përshkrimi	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Description								
Gjithsej	3,672,591	4,131,242	4,735,911	5,117,700	5,928,803	6,406,038	2,657,818	5,458,649
I Afrika	859	2,973	2,409	2,756	3,321	21,203	1,636	3,147
II Amerika	69,034	96,763	105,032	125,329	142,949	152,720	30,020	115,833
III Azia Lindore dhe Paqësor	30,874	33,032	36,551	54,343	69,152	78,050	4,993	7,698
IV Lindja e Mesme	2,697	3,034	4,797	5,688	7,174	11,707	1,813	36,959
V. Azia e Jugut	1,274	1,636	1,807	2,344	3,094	3,550	801	20,999
VI Evropa	3,423,665	3,759,423	4,490,014	4,694,260	5,331,616	5,706,003	2,616,909	5,172,845
- Evropa Qendrore / Lindore	163,006	161,467	167,527	276,563	362,093	393,368	92,328	363,483
- Evropa Veriore	137,308	125,513	149,992	204,009	212,248	234,958	65,173	127,707
- Evropa Jugore	2,821,920	3,169,174	3,855,779	3,810,454	4,301,950	4,636,197	2,335,914	4,331,659
- Evropa Perëndimore	237,700	248,811	221,560	316,204	357,411	417,163	95,211	293,064
- Evropa Lindore / Mesdheut	63,671	66,468	75,760	88,878	97,878	114,379	28,284	56,653
VI. Rajone të paspecifikuara	123,228	233,911	84,301	233,062	364,610	335,739	1,647	330,699

Figura 1.

Ky projekt synon të zhvillojë turizmin duke i dhënë mundësi njerëzve që duan të zbulojnë Lezhën dhe të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të organizuara.

2 - POZICIONI I OBJEKTIT

Objekti me emërtim : “Zyrë informacioni - Infopoint” me sipërfaqe 26m2 me vendodhje në Shëngjin, Lezhë në pjesën veri-perëndimore të Lezhës në Shëtitoren Eilson.

3 – GJENDJA EKZISTUESE

Ndërtimi i një zyre informative për turistat sic do jetë infopoint vjen si një domosdoshmëri në zhvillimin e turizmit bregdetar. Ky projekt synon gjithashtu që me Infopoint në Shëngjin të tërheqë më shumë turista me aktivitetet e ndryshme që i konvenon Lezhës si qytet historik. Bashkia Lezhë ka vënë gjithmonë si prioritet zhvillimin turistik dhe parashikon që me këtë implementim turizmi të zhvillohet në të Ardhmen.

Karakteristikat Arkitekturore të ndërtesës bazohen në kushtet klimatike duke mos prishur pamjen e bregdetit por edhe duke minimizuar rrezet e diellit brenda ambientit të zyrës. Pozicioni i zyrës është përcaktuar sipas zonës që të gjithë turistat të kanë munësi qasje të informacionit. Aktualisht zyra është projektuar në bazë të matjeve përkatëse dhe analizave topografike dhe klimatike.

4. -OBJEKTIVAT

Objektivi i përgjithshëm sic u trajtua në pikat e mëparshme është zhvillimi turistik dhe komunikimi i informacioneve të ndryshme për Lezhën tek turistat sezonal por jo vetem.

Objektivat arkitekturore kanë një drejtim të ndryshëm nga ai cfarë synon si objekt pas ndërtimit.

Synimet i ketij projekti nga ana arkitekturore janë:

- Ndërtimi i Zyrës Infopoint sipas plan vendosjes dhe projekt-preventivit te miratuar;
- Aksesibiliteti nga të gjithë personat duke krijuar drap në hyrje në ndihme të personave me aftësi te kufizuara;
- Minimizimi i rezeve të diellit me ane te binareve 11 cm X 11 cm në fasadën e jashtme ;
- Ndricimi i brëndshëm dhe i jashtëm me synim vizibilitetin tek turistat ;
- Vetratat e xhamit për arsye transparence dhe krijimin e një zone të sigurt për këmbësorët.

5. KUSHTET KLIMATIKE

Kushtet Klimatike në Lezhë janë tipiket e një vendi bregdetar të pozicionuar në veri- perëndim të nje shteti mesdhetar. Rreshjet janë të bollshme temperatura mesatare është 15 gradë. Duke marrë parasysh këtë fakt, fasada me vetrata xhami është vendosur kryesisht në drejtimin e Lindjes dhe dy fasadat e tjera te xhamit por e mbuluar me binarë druri jan vendosur ne fasaden Jug dhe Veri për mbrojtje nga dielli dhe era e Veriut. Fasada e Perëndimit është llogaritur e mbyllur totalisht për shkak të diellit dhe rreshjeve te shumta.

6. MENYRA E REALIZIMIT TE PROJEKTIT

Projekti do të realizohet në tre faza. Faza e parë Skicë - ide, e paraqitur tashmë, faza e dytë Projekt – ideja dhe faza e tretë Projekt – zbatimi, që paraqitet në këtë raport.

7. – HARTIMI I PROJEKTIT

Të gjitha vizatimet janë përpunuar në AUTOCAD dhe REVIT dhe do të dorëzohen në formatin PDF.

8. –ZGJIDHJA E PROJEKTIT

VLERA E INVESTIMIT DO JETE

3,714,441.22 PA TVSH.

9. GRAFIKU I PUNIMEVE

Kontraktuesi

Supervizori

Kontraktuesi duhet ti japë një program të plotë supervizorit duke i dhënë informacion mbi rendin, metodologjinë dhe procedurën si do procedojë ndertimi deri në përfundim të saj. Programi duhet të përmbajë informacione mbi detajet e vendosjes së strukturave të përkohshme dhe punëve të përkohshme që propozon për përdorim deri në përfundim të punëve, si dhe për fuqinë punëtore të kualifikuar dhe supervizimin e punimeve. Përpos kësaj, metodologjia dhe rregulli që duhet ndjekur për punimet e përhershme është për tu aprovuar dhe kontrolluar nga supervizori.

Punime të gabuara

Riparime

Punime të cilat nuk janë në përputhje me specifikimet e dhëna, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defect me shpenzimet e veta.

Ruajtja e prones

Kontraktuesi duhet të kryejë një studim dhe inventarizim të ndërtesave ekzistuese dhe strukturave të tjera që rrethojnë objektin pranë Punimeve. Këto struktura dhe ndërtesa ekzistuese që janë caktuar dhe lejohen të qëndrojnë duhet të mbrohen nga Kontraktuesi me shpenzimet e veta. Kontraktuesi gjithashtu duhet të kryejë një studim të trotuareve të rrugës ekzistuese që do të jenë si akses për punët në praninë e mbikëqyrësit.

Dorëzimet te Supervizori

Cdo document që Supervizori I dërgon kontraktuesit që përmbajnë instruksione ose udhëzime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kontrates do të jenë komunikime me shkrim.

Për cdo punim shtesë, kontraktuesi e ka për detyrë të të dorëzojë një vizatim të detajuar dhe vetëm pas aprovimit të supervizorit mund të fillojë procesi I punes. Nëse Supervizori ka nevojë për më shumë detajim ose testime mbi punimet shtesë, kontraktuesi duhet të ja sigurojë ato.

Punime prishje dhe pastrimi

Pastrimi I kantierit

Kontraktori duhet të heqë nga territori I punimeve të gjitha materialet vegjetare dhe ndërtuese, dhe të pastroje sheshin e ndërtimit.

Heqja me ekskavatorë dhe skarifikime, me dorë ose makinë nga terreni, nga cfarëdo lloj toke (terrene të ngurtë, rërë, zhavorri, shkëmborë) duke përfshirë lëvizjen e rrënjëve, trungjeve, shkëmbinjve duke mbrojtur strukturat e nëndheshme si kanalizime uji, naftë ose gazi . Përfshihet këtu dhe vendi I depozitimit të materialeve ose largimin e tyre në rast nevoje.

Heqja e shkurreve

Gjatë punimeve duhet pasur kujdes të mos dëmtohen ato pemë, shkurre etj, kur nuk pengojne ndërtimin e objektit të ri. Heqja e tyre duhet bërë duke ndjekur vizatimet dhe kufinj të sheshit të ndërtimit.

Mbrojtja e sheshit të ndërtimit

Kontraktori duhet të krijojë barriera mbrojtëse si mënyrë parandalimi aksidentesh të personave dhe objekteve rrethuese.

Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurojë që të gjithë punëtorët të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse. Ai duhet të sigurojë që vendi dhe pajisjet janë të siguruar nga një teknik kompetent dhe me experience dhe të një tipi dhe standarti të përshtatur vendit dhe punës që do procedohet.

10. PUNIME DHEU

Punimet dheu do të përfshijnë Gërmimin, Mbushjen dhe Ngjeshjen.

Shtresa e punimeve të dheut mund të jetë I shkruar, me ngjyrë të errët, me kripë ose material ranor me një përqindje të lartë të lëndëve organike të mirë tretura.

- Dheu me material të paqëndrueshëm

Materiali I cili nuk mund të parandalojë lëvizje të strukturës gjatë mbushjes, nuk ka qëndrueshmërinë për të paraprirë fugat që krijojnë ndarje në tub ose forcën për të ruajtur rregullsinë. Në procesin e mbushjes rekomandohet materiali I cili është gërmuar në kantier dhe duhet të jetë me përmbajtje argjitore, ose pa gurë ose materiale të huaja të tretuara. Ngjeshja bëhet me shkallën e duhur të përqindjes së dendësisë maksimale bazuar në procedurën e kërkuar të testimit.

11. Zbatimi

- **Gërmim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III**

Gërmimi do të përfshijë heqjen dhe hedhjen e të gjithë materialit. Materiali sic u përmend më sipër do të ruhet ose do të hidhet nëse nuk përdoren e njëjti material për ngjeshjen.

Gërmimi për strukturën duhet të bazohet tek matjet dhe mbushjet me një tolerancë plus minus 15 cm. Punimet e gropave të plintave përfshijnë përgatitjen e themeleve, duke niveluar dhe ngjeshur. Te gjitha gropat e themelit janë 90 cm thellësi me dimensione 100cm X 100cm të gropave të plintave të shpërndara. Gërmimet e dheut do jenë me krah e transport me k dore deri në 10 m. Cdo plint ka 100 cm

gjatësi dhe gjerësi, dhe 50 cm thellësi. Plintat e parapërgatitura janë ato plinta që janë të përforcuara dhe të ngurtesuara para se të vendosen në gropat e gërmimit të themelit, gjë që krijon që në cdo rast mund të zhvendosen lehtësisht.

- **Qëndrueshmëria e Gërmimeve dhe Përforcimet**

Duhet pasur kujdes me gërmimet dhe anët e gërmimeve duhet të jenë me pjerresi, me kend që të mbështesë materialin e gërmuar ose nëse këndi i anësuar nuk është i mundur mund të mbahen dhe lidhen në këto nyje. Material i gërmuar mund të hiqet me një kënd animi prej 45 gradësh nga fundi i gërmimit.

Përforcimet duhen derguar në nivelin e gërmimeve dhe të mos hiqen pavarësisht sa rrijnë të hapur gërmimet.

- **Rimbushja**

Hapi tjetër do jetë rimbushja me materialin përkatës rimbushës, të cilat duhen patur kujdes dhe duhet të jenë të depozituar në shtresa maksimale prej 15 cm, në thellësi të lirë. Materialet përreth duhet të nivelohen dhe ngjeshen terësisht. Të gjitha gropat dhe shtypjet duhet të hiqen duke i tërhequr me the dhe pastaj duket rrotulluar mbi to rrulat që janë të aprovuar që të ketë njëtrajtshmëri në sipërfaqe. Në shtresa duhet të mirëmbahet deri në vendosjen e parë të sipërfaqes.

- **Struktura e Ndërteses**

Struktura e ndërteses do jetë prej druri, dhe specifiku druri pishe Xlam. Vendosja e kollonave të drurit dhe të trave kryesore dhe dytësore do të kryhet pasi kallepet janë hequr totalisht. Kollonat strukturore kanë një dimension 25cmX25cm duke llogaritur faktin që është një katësh. Trate kryesore që do lidhin këto kollona tek niveli ± 0.00 (baza) dhe tek +3.00 (fillimi i catisë) janë të një dimensionit 24cm X 24cm.

Kornizat e drurit për muret janë të parapërgatitura dhe me tratë dytësore me dimensione 11.4cm X 11.4cm. Këto konstruksione druri nderlidhen me njëra tjetren me bulona hekuri dhe pervec kornizën e murit lënë hapësirë dhe për kornizat e dritareve dhe deres. Në momentin që korniza e drurit qëndron në peshen e saj

lyhen me bojë vaji që është e përshtatshme për sipërfaqe druri. Bazuar në të gjithë konstruksionin e drurit që do bëhet boja e vajit duhet të jetë e mjaftueshme për 148 m² dru.

Dyshemeja

Ndertimi i dyshemese do jete me tra dytesore mbeshtetese 12 cm X 12cm bazuar sipas vizatimit teknik dhe kompensata e drurit si shtrese derrase niveluese me FM = 4 cm dhe shtrese parketi per shtrimin e dyshemese.

Ndërtimi i mureve

Duke u bazuar në kohën e lagësht të qytetit të Lezhës, ndërtimi i murit do të jete me knauf me $t=10$ cm me dy shtresa që të jete kunder lageshtires. Ndërtimi i mureve do të vijojë me lysterje me boje hidroplastike importi cilesi e I-re për të niveluar dhe ne vijim patinimin me stuko Veneciane dhe savatim I mureve me grafiato $h>4$ m me bojë ngjyre të bardhë. Lysterja është përllogaritur për muret e jashtëm dhe të brëndshëm me sipërfaqe totale 72m².

Catia

Catia ka për konstruksion atë të drurit dhe pjerrësi 17% që krijon një mundësi shumë të mirë të shkarkimit të ujit të shiut ku do ketë ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33 cm që e rrethon catinë dhe atë vertical me llamarinë xingat 100 mm ku do jëtë e vendosur bashkë me kaseten e shkarkimit llamarinë xingat sic është treguar në vizatimet teknike që do pajisen përsoneat përgjegjës.

Tavani do jetë me kartonxhes dhe me patinim tavani me stuko Veneciane me sipërfaqe 29m². Catia do jetë me konstruksion druri dhe me mbulim me panel sandwich $t=30$ cm e cila do jete me 2 shtresa perberje druri dhe ne mes te dy shtresave te drurit nje shtrese izoluese.

Trotuari do jete e parapergatitur pa borduren e betonit që të krijojë akses nga trotuari kryesor tek hyrja dhe me drap që nuk e tejkalon 8.3 % gradë për njerëzit me aftësi të kufizuar.

Hidromekanike

Objekti është krijuar pa kanalizime ose instalime hidraulike e vetmja gjë që do përfshihet këtu është fiksja e zjarrit me pluhur tip bombel (i levizshem) që e ka ne specifika që mund të mbuloje gati ne 30 m diagonale të një vendi.

Punime vetrate d/alumini plastike me dopio xham

Në kornizat e drurit te parapërgatitura që u ndërtuan muret janë hapësirat e dritareve dhe dyerve që ndryshojnë si përmasa dhe për këtë përsoni në mbikëqyrje duhet të bazohet tek vizatimet teknike. Në momentin e vendosjes së dritareve dhe dyerve cdo instalim duhet të jete me izolimet përkatëse që e rrethon kornizën e vetrateve të d/alumini. Alumini i përdorur në strukture propozohet të lyhet në ngjyre të zezë (black 9005 Jet) në versionin mat (lyerje me spruco)

Izolimet

Per dyshemene sugjerohet shtrese izolimi PVC dhe per muret shtrese izolimi leshin mineral.

Punime elektrike

Instalimi elektrik do kryhet gjate ndërtimit të mureve dhe pas përfundimi të saj do vendosen shiritat Led sipas vizatimeve teknike për fasaden e jashtme dhe ndricues tavanor për ambientin e brëndshëm. Përpos kësaj, instalime të celësave pola dhe prizave për komandimin e dritave dhe për monitorët dhe televizorët që do vendosen. Ndricuesat tavanor do jene fluoreshente 1x40W dhe do jenë dy copë ne qendër të zyres. Pjesa e tjetër e kasetave dhe tubave të plastmasit dhe automatit termo/el.manj.diferencial 2P 220V, 40A supervizori dhe punëtorët do bazohen tæk vizatimet teknike dhe preventivi. Gjithashtu do jetë i instaluar si dhe interneti dhe kutia shpërndarëse .

Pajisjet

Pajisjet vijojne me monitor me touch per informacion që do jetë 33'' e pajisur me tastierë dhe mouse të lidhur me internetin e instaluar në zyrë. Gjithashtu zyra do ketë një televizor LED showcase (për të paraqitur fotot dhe informacionet në fasaden e xhamit dhe do jete 43'' 4k te tipit dhe do jetë vetëm 1 copë që kryeje këtë funksion. Një kompjuter PC desktop 18'', 8GB, 512GB SSD me AMD Ryzen 5 si processor për receptionistat që të përdoret per informacionin që kërkohet nga qytetarët. Banak receptioni me panel druri AHU me materiale MDF me dimensione 240WX75DX110H do vendoset sipas vizatimeve teknike bashke me 2 stolat me konstrukcion metal të lyer ne ngjyre të zeze dhe ne ndenjese shpinore me lekure te perpunuar me përmasa: 48x51x101 cm.

Lartësia e sediljes: 75 cm.

Dimensionet e sediljes: 40x37 cm.

Bazuar përsëri në vizatimet teknike 2 karrige metalike pritëse për qytetarët do jënë të vendosur, gjithashtu me nje system kamerash me 4 porte 5mpx për sigurinë e zyrës. Instalimi i kondicionerit 18 btu do jetë bazuar ne vizatimin teknik ku është e shënuar priza e posacme për kondicionerin.

· Sic u trajtua në pikat e mëparshme ndërtimi i këtij objekti prej sipërfaqeje 26m2 do konstruktohet hap pas hapi bazuar në vizatimet teknike dhe preventivin.

Materiali grafik paraqet :

- plan-vendosjen ne SH.1 : 35

Hartues:

Ark. Eli Gjoka

Ing. Alban Laçi